



Datë: 26.02.2026  
Numër Protokolli: 1042/2026

A.nr.1767/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1767/2025, të datës 08.10.2025, të parashtruar nga ankuesi M.Sh,kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.02.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1767/2025, e datës 08.10.2025, e parashtruar nga ankuesi M.SH.

**II. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ri procedoj kërkesë pranë Thesarit të Kosovës për realizimin e kompensimit material sipas Vendimit numër 14-016/01-32139/24, të datës 04.03.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

**III. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas pikën II të dispozitivit, të ekzekutoj kompensimin financiar të njohur më Vendimin numër 14-016/01-32139/24, të datës 04.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi M.SH (*tutje referuar ankuesi*), fizikisht më datë 08.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos ekzekutimin e të ardhurave personale 50% të pagës nga data 11.04.2014 deri më datës 15.03.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, me datë ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 6632/2025 të datës 08.10.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin me numër 01-112-857 i datës 15.03.2024; Përgjigjen në kërkesë e datës 15.10.2025; Konstatimin nga komisioni për vlerësimin e pagave dhe kontributeve; Emailin e datës 17.03.2025 nga A.A për A.T, N.B dhe E.D; Formularin për pagës retroaktive i datës 12.03.2025; Kërkesë për procedim të pagave datës 12.03.2025 nga Komuna e Prishtinës për Thesarin e Kosovës; Vendimin e datës 12.12.2024; Ri kërkesën e datës 16.09.2025 të ankuesit për Sektorin e Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër 14-016/01-32139/24 të datës 04.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimin e datës 15.03.2024; Aktgjykimin APS.nr.52/23 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.10.2025; Ri kërkesën e datës 06.08.2025 të ankuesi për Kryetarin e Komunës së Prishtinës; Akt emërimin e datës 19.11.2024; Vendimin 01nr.118-87643 të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Aktgjykimin PKR.nr.601/21 të datës 16.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është e bazuar, **sepse:**

### I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prishtinës dhe së i njëjti sipas Vendimit 01nr.118-87643 të datës 11.04.2014, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është pezulluar me 50% të pagës deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata, për shkak të ndjekjes penale për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar.
- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special me Aktgjykimin PKR.nr.601/21 të datës 16.10.2023. e kishte shpallur ankuesin fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar duke e dënuar me gjashtë (6) muaj më burgim, i cili më pëlqimin e tij është shndërruar në dënim me gjobë prej 10.000 Euro.
- Gjykata e Apelit e Kosovës në procedurë të ankesës, më datë 11.01.2024 ka nxjerr Aktgjykim APS.nr.52/223, me të cilin ankuesi është liruar nga akuza për shkak të kalimit të afatit absolut të ndjekjes penale.

-Kryetari i Komunës së Prishtinës, më Vendimin me numër 14-016/01-32139/24, të datës 04.03.2024, ankuesin e ka kthyer në vendin e punës në pozitën Inspektor i Ndërtimit, duke i njohur edhe të drejtën e kompensimit të 50% të të ardhurave personal nga data 15.03.2014, ndërsa, më datë 15.03.2024 i është lëshuar Akt Emërimi AE.Nr.01-112-857 për pozitën Inspektor i Ndërtimit.

-Kryetari i Komunës së Prishtinës me Vendimin me numër 14-020/04-164090/24 të datës 12.12.2024, ka caktuar komisionin për vlerësimin e pagave dhe kontributeve për nëpunësit civil të kthyer në punë sipas aktgjyqimeve të formës së prerë dhe vendimeve të KPMSHCK-së, ndërsa komisioni pas vlerësimit të pagave dhe kontributeve të nëpunësve civil ka konstatuar duke bërë vlerësimin e pagave dhe kontributeve në mesin e të cilëve është edhe ankuesit.

-Më datë 12.03.2025, Komuna e Prishtinës, ka paraqitur kërkesë tek Thesari i Kosovës për procedimin e pagesave në mënyrë retroaktive në bazë të vendimeve gjyqësore dhe KPMSHCK-së për shtatë zyrtar mesin e tyre edhe ankuesin, mirëpo nuk është realizuar.

-Ankuesi më datë 06.08.2025 dhe 16.09.2025, ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, duke kërkuar kompensimin e pagave për periudhën nga data 11.04.2014 deri më datë 15.03.2024.

-Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, përmes, Zyrtarit të Lartë i Personelit më datë 18.09.2025 i është përgjigjur Menaxherit të Personelit, lidhur me kërkesën e ankuesit, duke e njoftuar se ka ndërmarr të gjitha veprimet për zbatim të vendimeve të gjykatave dhe KPMSHCK-së.

## II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme ende nuk është bërë kompensimi sipas obligimeve që kanë dal nga vendimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kthimin në vendin e punës, duke kërkuar kompensimin e pagave nga data 11.04.2014 deri më datë 15.03.2024.

## III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të pranushëmrisë së ankesës dhe duke qenë se objekti i ankesës ka të bëjë me kërkesë të natyrës materiale, Kolegji konstaton se ankesa konsiderohet e ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Ndërsa, në kuptim të drejtës së ankuesit në kompensim të 50 % pagës së ndalur si pasojë e pezullimit për shkak të inicimit të procedurë penale, Kolegji thekson faktin se kjo e drejtë materiale i është njohur më Vendimin 01nr.118-87643 të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i aplikueshëm në kohën e pezullimit të ankuesit sipas Vendimit 01nr.118-87643 të datës 11.04.2014, e më të cilin ligj me nenin 69, në mënyrë shprehimore përcaktohej: *1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjykimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet. 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë*

*për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi.*

Andaj, duke qenë se aktakuza ndaj ankuesit (PPS.nr.25014, e datës 11.06.2015) nuk ka mundur të vërtetohet për shkak të rrethanës ligjore të parashkrimit të ndjekjes penale, atëherë, më të drejtë Kryetari i Komunës e ka kthyer ankuesin në vendin e punës, duke i njohur edhe kompensimin e 50% të të ardhurave personale nga dita e pezullimit deri në ditën e kthimit në vendim e tij te punës, rrjedhimisht, duke vepruar në pajtim me përcaktimet ligjore sipas nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, duke qenë se përkundër kërkesës së datës 12.03.2025 të organit të punësimit për kompensim të ankuesit, Thesari i Kosovës nuk ka aprovuar kërkesës në fjalë, atëherë, nisur nga konstatimi mbi të drejtën e ankuesit për kompensim material si objekte i kësaj ankesë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

A.nr.1767/2025

***Avdyl BEKTESHI***

*Procesmbajtës*

***Ardita Haxhnikaj DEMI***

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit M.SH;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Komunës së Prishtinës: ZKF-ës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK- së.